

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLICA KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA	
MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË	
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEKNOLOGIJE	
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY	
SEKTORI I ARKIVES-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica	01/B
Nr. i faqeve	4
Br. stranica	
No. pages	
Nr. Prot. Broj Prot. Prot.No.	1670
Data: Datum: Date:	05.06.2024
Prishtinë, /a	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstvo za Obrazovanje, Nauke i  
Tehnologija--Ministry of Education Science and Technology

Zyra e Sekretarit të përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the  
General Secretary

Numër: 01B-060  
Datë: 05.06.2024

**Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit**, në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1.19 të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 17, 16 shtator 2011), nenit 11 paragrafit 1, nënparagrafit 1.5 të Ligjit nr. 08L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (G. z. e Republikës së Kosovës /nr. 34 / 18 nëntor 2022, Prishtinë), nenit 5, shtojcës 1 pikës 7.1, 7.6, 7.7, dhe 7.8 të Rregullores (QRK) nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dhe në bazë të programit CEEPUS, nxjerr:

## V E N D I M

**Rregullat e përgjithshme për pjesëmarrje në programin CEEPUS, kriteret për përkrahje të mobiliteteve në Programin CEEPUS, lejimin e pjesëmarrjes së institucioneve publike dhe private dhe pagesat e mobiliteteve**

1. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) në nivel kombëtar koordinon programin “Programi për shkëmbim të studentëve dhe stafit akademik në Evropën Qendrore për shkëmbim të mobiliteteve” këtu e tutje si „CEEPUS” dhe pjesëmarrja në program mundësohet me ofrimin e bursave përmes „muajve” për çdo vit akademik me shkresë zyrtare nga Ministri/Ministrja dorëzuar zyrës qendrore të CEEPUS e cila koordinohet nga Austria.
2. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ka të drejtën brenda kompetencave të saj të vendos për pjesëmarrje apo jo në nivel vendi për këtë program.
3. MASHTI ofron mundësi për aplikim për krijimin e rrjeteve/partneriteteve me universitetet e vendeve pjesëmarrëse në programin CEEPUS dhe aplikimin për mobilitete për të gjitha institucionet e arsimit të lartë publike dhe private në Republikën e Kosovës të cilat janë të akredituara dhe licencuara sipas rregullave dhe procedurave të programit CEEPUS dhe rregullave specifike në nivel vendi sipas këtij vendimi.

4. Koordinatorët e rrjeteve pjesëmarrëse si partner në rrjete apo koordinator lokal të Kosovës për rrjet, duhet të kenë aprovimin e Rektorit apo prorektorit për bashkëpunim ndërkombëtar të institucionit të tij për të menaxhuar rrjetin përkatës. Forma e dokumentit është përcaktuar në programin CEEPUS.
5. Koordinatorët/pjesëmarrësit në rolin e partnerit në rrjete janë përgjegjës për bashkëpunimin me Ministrinë, bashkëpunimin me partnerët e huaj në rrjetin pjesëmarrës, zyrën qendrore të CEEPUS sipas kërkesës, planifikimin dhe menaxhimin e duhur të mobiliteteve, procedimin e aplikimeve, aprovimin apo refuzimin e mobiliteteve online të aplikuesve vendorë dhe të huaj, organizimin e orëve/ligjëratave/kurseve të dedikuara për mobilitetet e huaja për qëllime akademike apo orientimi dhe këshillimi i duhur në Fakultetin e tij, lëshimi i dokumenteve të konfirmimit dhe raportit për mobilitetet pritëse. Koordinatorët e rrjeteve informojnë Menaxhmentin e lartë të institucionit të tij/saj, stafin akademik dhe studentët për mundësitë e pjesëmarrjes për njësinë/departamentin e tij.
6. Përfitues të mobilitetit mund të jenë studentët dhe anëtarët e fakultetit (stafi mësimor, zyrat për bashkëpunim ndërkombëtar, kërkimor dhe/ose artistik) një Universiteti dhe apo institucion i arsimit të lartë, që janë nga vendet pjesëmarrëse në CEEPUS. Studentët duhet të kenë përfunduar me sukses dy semestra të një kursi të rregullt studimi për t'u kualifikuar, përveç kurseve intensive.
7. Institucionet e arsimit të lartë publik dhe privat dhe aplikues individual, janë të obliguar të zbatojnë të gjitha rregulloret, programet e punës dhe procedurat e Programit CEEPUS të cilat rrjedhin nga shtetet e CEEPUS.
8. Përzgjedhja e studentëve dhe profesorëve për mobilitet në kuadër të skemës së CEEPUS si mobilitet i rrjetit apo mobilitet i lirë, "free mover" bëhet nga vet institucionet e arsimit të lartë vendor dhe të huaja, përkatësisht koordinatorët e rrjeteve apo rregullave pritëse për të huaj që mund ti ketë vet.
9. Për mobilitetet ndërkombëtare/vizitorë të huaj në institucione të arsimit të lartë publik mbulohet akomodimi në Qendrën e Studentëve dhe ofrohet vlera e grantit si në vijim:
  - 9.1. Për qëndrimin e studentëve për ekskursione të shkurta/dhe apo shkolla verore nga 3 deri në 6 ditë, ofrohet bursa në vlerën prej 100 (njëqind) euro;
  - 9.2 Për qëndrimin e studentëve të huaj nga 7 deri në 15 ditë/ dhe apo shkolla verore, ofrohet granti prej 125 (njëqind e njëzetë e pesë) euro;
  - 9.3. Për qëndrimin e studentëve nga 16 ditë deri në një muaj, ofrohet granti prej 250 euro në muaj;
  - 9.4. Për qëndrimin e studentëve për një semestër, ofrohet granti prej 250 euro në muaj. maximumi 10 muaj për nivel studimi.
10. Për qëndrimin e mësimeve/profesorëve të huaj ndërkombëtar në kategorinë përkatëse, vlera e grantit ofrohet si në vijim:
  - 10.1. Qëndrimi për ekskursione të shkurta/ dhe apo shkolla verore prej 3 deri 6 ditë, ofrohet granti prej 50 (pesëdhjetë) euro në ditë;

10.2. Qëndrimi në kategorinë e mobilitetit profesor i cili qëndrim duhet të jetë së paku 5 ditë pune deri në një muaj dhe që përfshin mbajtjen e minimum 6 orë mësimi/ligjërata ose aktivitete mentorimi, ofrohet "granti mujor" prej 350 euro;

10.3. Studentëve dhe profesorëve ndërkombëtar/vizitorë, do t'ju mbulohet akomodimi në Qendrën e Studentëve.

11. Studentët/profesorët që kanë shtetësi të Kosovës dhe shtetësi të vendit pjesëmarrës të CEEPUS ku vijohen studimet e rregullta apo punësim i rregullt dhe me qëndrim të përhershëm në atë vend mund të aplikojnë dhe përfitojnë shkëmbim mobiliteti në IAL publike në Kosovë, të cilët sjellin dëshmitë e lëshuara nga organet kompetente sipas kërkesës.

12. Sipas rregullave dhe programeve të punës së programit CEEPUS, nëse aplikohet nga vendet pjesëmarrëse, përfitues dhe shkëmbim mobiliteti mund të jenë edhe stafi i zyrave të bashkëpunimit ndërkombëtar në IAL.

13. Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit në vendet pjesëmarrëse të CEEPUS mbulohen nga vendet pritëse sipas tarifave të atij shteti. Shpenzimet e biletës së udhëtimit për mobilitetet e institucioneve të arsimit të lartë publik në Republikën e Kosovës bëhen përmes rimbursimit me dëshmi të faturave dhe mbulohen nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës si në vijim:

13.1. Studentët kosovar në IAL të cilët janë përfitues të mobilitetit, do t'ju rimbursohen shpenzimet e udhëtimit të biletës në vlerë prej deri 100 euro;

13.2. Profesorëve kosovarë të cilët janë përfitues të mobilitetit, do t'ju rimbursohen shpenzimet e udhëtimit të biletës së udhëtimit në vlerë prej maksimum deri në 400 euro;

13.3. Stafit të zyrave të bashkëpunimit ndërkombëtar në IAL publike, nëse aplikohet si kategori sipas programit CEEPUS, do t'ju rimbursohen shpenzimet e udhëtimit të biletës së udhëtimit në vlerë prej maksimum deri në 400 euro;

13.4. Mbulimi i shpenzimeve të biletës mund të refuzohet nga MASHTI, në rast se nuk ka buxhet të mjaftueshëm dhe në rast të dështimit nga pala përfituese për dokumentim të shpenzimit.

14. Për rimbursimin e biletës së udhëtimit, stafi akademik dhe studentët nga Kosova duhet të sjellin dokumentet si në vijim:

14.1 Kërkesën për rimbursim;

14.2. Konfirmimin bankar personal në Kosovë;

14.3. Kopjen e letërnjoftimit;

14.4. Dëshmi të lëshuara nga institucioni pritës i huaj për mobilitetin;

14.5. Faturat origjinale të lëshuara nga agjencia e udhëtimit dhe apo faturë e blerë online në formë elektronike.

15. Institucionet e arsimit të lartë privat të akredituar dhe licencuar lejohen të marrin pjesë në program duke u lejuar qasja në sistemin online të CEEPUS dhe krijojnë partneritet për shkëmbimin e mobiliteteve si në vijim:

15.1. Institucionet e arsimit të lartë privat në Republikën e Kosovës të cilat shprehin interes të bëjnë rrjetëzim për shkëmbimin e mobiliteteve, paraprakisht lidhin marrëveshje mirëkuptimi

me MASHTI. Në rastet kur nuk ka marrëveshje me MASHTI, stafi akademik dhe studentët mund të aplikojnë vetëm në kategorinë “freemover”;

15.2. Profesorëve dhe studentëve të huaj të cilët janë përfitues për shkëmbim të mobilitetit në ndonjë institucion të arsimit të lartë privat, shpenzimet e tyre i bart institucioni pritës i arsimit të lartë privat në Republikën e Kosovës. Institucioni është përgjegjës për informimin e saktë të palëve përfituese mbi pagesën, akomodimin dhe informatat rreth mobilitetit të tij/saj në institucionin e tij;

15.3. Mësimdhënës/profesorë/staf kosovar vendor të punësuar në institucionet e arsimit të lartë privat në Republikën e Kosovës të cilët janë përfitues të mobilitetit jashtë vendit në programin CEEPUS nga këto IAL, vendimin për aprovim apo refuzim dhe shpenzimet e rimbursimit të biletës janë në kuadër të vet institucionit;

15.4. Studentët shtetas të Kosovës të cilët vijnë në studimet në IAL private të Kosovës që janë përfitues i mobilitetit në CEEPUS mund të aplikojnë për rimbursim të biletës në MASHTI në vlerë maksimale prej deri në 100 euro. Procedura e rimbursimit është përcaktuar në pikën 14 të këtij vendimi.

16. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi nr. 2-897 dt. 27.04.2018.

17. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### Ar sy e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë, rregullat e përgjithshme për Programin CEEPUS dhe rreth promovimit të lëvizjes së studentëve dhe personelit akademik në zonën evropiane të arsimit të lartë, përkrahje në partneritete të drejtpërdrejta në mes institucioneve të arsimit të lartë dhe stafit akademik, shkëmbimin akademik në fusha të ndryshme dhe rritjes së diversitetit kulturor, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### Vendimi u dërgohet:

1. Ministres;
2. DNASHT;
3. Zyrës së SP/MASHT;
4. IAL;
5. DALSH;
6. Arkivit.



**Arbërie Nagavci, ministre**